



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 060/01-21650/2022

Datë.28.09.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tetë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2022 e mbajtur me dt.28.09.2022, me fillim në orën 10.00, në sallën Solemne të Pallatit të Kulturës rruga “UÇK” Gjakovë.

Mbledhjen e kryesoi : znj. Arbënesha Kuqi , Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës .

Në mbledhje marrin pjesë **35** anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Agustin Shala, znj. Albina Sadrija, z. Him Zeqa, znj. Teuta Pallaska Milla, z. Nik Hiseni, z. Hekuran Hoxha z. Valon Pnishi, znj. Ermira Mehmeti, znj. Albulena Zuka, z. Besim Kadrija z. Ngadhnjim Dana, znj. Mimoza Shala, z. Mustafa Domi, znj. Diana Qarkaxhija z. Ali Tafarshiku, z. Kreshnik Alijaj, z. Ledian Rexha, znj. Shqipe Fejza z. Agon Dobruna, z. Ermal Kusari, z. Bashkim Gashaj, z. Liridon Dula, znj. Lirianda Dahsyla, z.Teki Shala, z.Nexhdet Morina, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Besim Ndau, z. Ardian Nushi, znj. Lerena Kameraj, znj. Krenare Bushaj, z. Fazli Hoxha.

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini Nënkryetari z. Flamur Fetahaj, Drejtor të Drejtorive Komunale, përfaqësues të Mediave të OJQ-ve, të OSBE, qytetar të Komunës së Gjakovës, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal.

Kryesuesja: I nderuar Kryetari i Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini, Nënkryetari z. Flamur Fetahaj të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës, të nderuar drejtor të drejtorive Komunale, përfaqësues të mediave, të OSBE, zyrtar komunal të nderuar të pranishëm.

Sot e kemi mbledhjen e tetë të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, Materialin dhe ftesën për këtë mbledhje ju kemi shpërndarë sipas afateve të parapara ligjore, të papranishëm janë 35 anëtarë, meqenëse ekziston Koriumi po fillojmë me mbledhjen a ka ndonjë diskutim apo kërkesë për pikat e rendit të ditës sipas ftesë që e keni marrë .

znj. Mimoza Shala: Lëvizja Vetëvendosje propozon që si pikë e rendi të ditës të shtohet edhe një raport për reshjet e fundit që kanë ndodhur në Komunën e Gjakovës .

Kryesuesja: Meqenëse sot këtu nuk e kemi një raport të detajuar mundem me e diskutua në të ndryshme nëse pajtoheni, fillimisht kërkojmë që ta diskutojmë në këtë mbledhje edhe një pikë shtesë që ka të bëjë për ndarjen e parcelës për ndërtimin e zyrës regjionale të Agjencisë të Ushqimit dhe Veterinarisë në Gjakovë materialet dhe dokumentet e kompletuara të këtij propozim vendimi ju kemi shpërndarë në tavolinat e juaja andaj propozoj që të diskutohet në këtë mbledhje si pikë 12 e rendit të ditës .

Kryesuesja: Meqenëse nuk ka propozime e qes në votim rendin e ditës sipas ftesës së bërë me këtë pikë shtesë. Kush është Pro, Kundër , Abstenim. Nga anëtarët e pranishëm **unanimisht u votua pro** rendit të ditës.

Pas votimit të bërë u miratua ky :

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 28.07.2022.
2. Pyetje për ekzekutivin nga anëtarët e kuvendit.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Gjakovës për vitin 2023 .
5. Propozim Vendimi për caktimin e një pjese të parcelës nr.P70705077-00107-0 në Z.K Firzë për ndërtimin e “Qendrës Ditore për Pensionistë “ .
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për miratimin e kërkesë për Hartimin e Draft Statutit të Komunës së Gjakovës dhe ndjekjen e procedurave për ndryshimin e Simboleve të Komunës së Gjakovës .
7. Draft Kodi i Etikës në Komunën e Gjakovës .
8. Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa Komunale 01 nr.011/01-19340 i dt. 28.07.2022.
9. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit 01 nr.011/01-5477 i dt.07.03.2022 për mbështetje Financiare të Shoqatës “Handikos Gjakovë “ .
10. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit 01nr.0112/02-19351 i dt.28.07.2022 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave për emërtimin e rrugëve .
11. Rishqyrtimi i Vendimit 01nr.011/01-19353/2022 i datës 28.07.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë .
12. Shqyrtimi i Propozim Vendimi për ndarjen e parcelës për ndërtimin e Zyrës regjionale për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë .
13. Informatë mbi përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor në Komunën e Gjakovës 2022-2023.
14. Të Ndryshme

1.Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Procesverbalit nga Mbledhja e mbajtur me dt. 28.07.2022

Kryesuesja: A ka dikush ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e fundit e mbajtur me datë 28.07.2022 e hapi diskutimin nëse keni ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket këtij procesverballi.

E qes në votim miratimin e procesverbalit nga mbledhja e fundit e mbajtur me dt. 28.07.2022. Kush është Pro, Kundër, Abstenim.

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës unanimisht u miratua procesverballi nga mbledhja e Kuvendit e mbajtur me datë 28.07.2022

2. Pika e dytë e rendit të ditës : Pyetje për ekzekutivin nga anëtarët e kuvendit

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Pyetje për ekzekutivin nga anëtarët e kuvendit, andaj e hapi diskutimin për këtë pikë .

znj. Shqipe Fejza: Meqenëse jam anëtare e Komitetit për Komunitete po ju njoftoj se anëtarët tjerë të këtij komiteti janë në teren dhe më informuan se të gjithë banoret që janë evakuuar për shkak të vërshimeve sot janë kthyer në shtëpitë e tyre dhe kërkojnë sqarime se çka është duke bërë komuna në këtë drejtim, dhe sa është qiraja që mundet komuna me ju dhënë, për rrugën 14 Qershori keni marrë kërkesë në drejtorin e shërbimeve publike dhe që 4 muaj ende nuk e keni realizuar atë kërkesë, pyetje tjetër banorët e rrugës Hamdi Bajraktari në Hereqë kanë kërkuar trotuare dhe polic të shtrirë sepse janë të rrezikuar nga shpejtësia e makinave në këtë rrugë në të cilën mungon edhe ndriçimi Publik.

z. Ali Tafarshiku: Po e vërejmë se kemi mungesë të përfaqësimit të zyrave këtu në kuvend veçanërisht të zyrës së Prokurimit Publik sepse kemi pyetje për tenderin e furnizimit me lule, ofertuesit i është dhënë arsye se nuk i ka plotësuar kushtet e tenderit ku me të njëjtat dokumente e ka fituar tenderin në vitin 2021 dhe tani i është refuzuar, ku është duke u furnizuar komuna me lule në këtë kohë. Pyetje tjetër ka të bëjë me shpronësimin e familjes Kalaveshi në Kullën Sylejman Vokshi, sepse kontesti gjyqësor ka të bëjë me

pronat për rreth e jo me kullën. Pyetje tjetër të gjithë e dinë se me çfarë gjendje janë përball qytetarët nga reshjet e fundit është hap një aplikim për ti prezantuar dëmet e shkaktuar a do të kompensohen nga komuna apo veç janë hapë këto aplikime vetëm për nevoja të drejtorisë .

z. Nexhdet Morina: Unë kam një pyetje për Kryetarin e Komunës lidhur me urën në Rogovë a ka diçka të re për këtë projekt nga niveli Qendror apo ai Lokal, si dhe pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike që ka të bëjë me rrugën Shefki Thaqi sepse është e disata herë që po kërkojmë që të intervenohet në atë rrugë dhe ende nuk është bërë asgjë, si dhe rruga Ibrahim Asllan Shala që nuk ka fare ndriçim Publik .

z. Ardian Nushi: Fshati Doblibare ka kërkuar që të përfundoj rruga e Kuvendi i Lezhës sepse gjysma është e përfunduar andaj kanë kërkuar që të përfundoj kjo rrugë sa më parë që është e mundur .

z. Teki Shala: Unë i kam disa pyetje për urën e Rugovës, a ka ndonjë projekt konkret për ndriçim Publik me shtylla adekuatë, si dhe a ka ndonjë projekt të mesëm në Komunën e Gjakovës që është ka realizohet edhe nga Buxheti i Komunës edhe nga ai Qendror, si dhe a ka plan të ndërtohet kanali i ujerave atmosferik në Rogovë që ka filluar në kohë fushate sepse sikur të ishit ky kanalizim nuk do të ndodhnin ato përmbajtje në atë zonë .

z. Agon Dobruna: Meqenëse jemi në sezonën e dimrit si qëndron situata me ngrohtoren e qytetit a është sigurua biomasa dhe çfarë masa keni marrë për grumbullimin e kësaj biomase me agjencinë e pyjeve dhe akterët tjerë si dhe pse nga 3 kalldaja ajo për prodhimin e energjisë nuk është në funksion pra në çfarë faze jeni me sigurimin e biomasës dhe për çështjen që e kam ngrit edhe në fillim të verës si mundeni me e bë një zgjidhje për dy vëllezërit e familjes Bedra që jetojnë në park të qytetit në Veturë kërkoj që të merret seriozisht kjo çështje .

z. Liridon Dula : Pyetja ime është për Drejtorin e shërbimeve Publike pse ende banorët e fshatit Stubull nuk kanë Ndriçim Publik .

znj. Krenare Bushaj: Në Buxhetin e kaluar kemi Buxhetuar rrugën në fshatit Trakaniq dhe në Palabardh duke marrë parasysh se jemi në fund të vitit 2022 këto rrugë janë të projektuara dhe të buxhetura por ende nuk kanë filluar punimet a do të fillojnë punimet në këto rrugë apo do të vazhdohet kështu.

z. Ledian Rexha: Për rrugën Muharrem Domi kemi probleme me mbeturinat inerte dhe vozitja e shpejtë që po bëhet në këtë lagje po shkakton rrezik për banorët, aty është bërë qendër edhe për përdoruesit e narkotikëve dhe banorët kanë kërkuar që të vendosen Policët e shtrirë dhe të vendosen kamerat .

znj. Mimoza Shala: Vetëm në këtë mbledhje janë katër vendime që janë kthyer nga Ministria dhe secila prej tyre ka shkelje ligjore a keni marrë masa ju znj. Kryesuese ndaj Zyrës Ligjore që këto gjëra mos të ndodhin sepse kjo nuk është në rregull .

Kryetari: Unë po ju njoftoj se në këtë vit në përjashtim të Udhëtimeve Zyrtare vetëm 7 dit pune i kam bërë pushim andaj mos me thuani mua mirë se erdhe sepse unë kam qenë këtu, Sa është qiraja nuk mundemi me e ditë por jemi zotë që e paguajmë, por duhet të kemi një marrëveshje të qeras sepse nuk mundemi me e pagua ndryshe kemi mundësi financiare dhe kemi vullnet me i pagua këto qera për këta banor, i kemi lut me i gjet vendbanim të përkohshëm dhe do të punojmë për me ju gjet një zgjedhje të përhershëm, për ndriçimin publik e kemi kontratën jemi duke punuar dhe do të mbërrijmë me e zgjerua ndriçimin gradualisht, numri i dëmtimeve të pajisjeve të rrjetit janë të shumta dhe kërkoj edhe nga ju që të bëni thirrje për mos me e dëmtua pronën publike, Përfaqësuesi i Zyrës së Prokurimit dhe të tjerët janë shërbyes Civil dhe nuk marrin pjesa në mbledhje të Kuvendit por vetëm nëse ka pyetje konkrete, për tenderin për lule nuk e di do të informohem dhe do të ju njoftojmë se si është puna, për Kullën Syklemen Vokshi e dimë se rasti Gjyqësor ka të bëjë me parcelën që do të shpronësohet dhe kuvendi i Komunës ka marrë vendim me e ndryshua vendimin për parcelën që do të shpronësohet dhe ai vendim është kontestua nga ministria që nuk është në rregull sepse kjo është në kompetencë të komunës dhe për këtë jemi në gjyq, tani jemi duke e pritur vendimin e Gjykatës dhe në

momentin që do ta kemi një vendim të tillë do ti vazhdojmë procedurat ligjore . Komunat nuk kanë fonde emergjente dhe ne jemi dakorduar me nivelin qendror që Qeveria do ti kompozoi pasi që komunat të bëjnë Vlerësimin e dëmeve ekipet janë në teren dhe menjëherë si të kryet vlerësimi do ti përcjellim për Ministri, Kemi biseduar për Urën e Rugovës jemi në diskutim se a do të kryejnë ministria apo komuna hartimin projektit ne jemi ofruar që të kryejmë por ende nuk është vendosur, për ndriçim do të mbrojmë edhe në Rogëvë, për rrugën në Doblibare do të shikojmë pse ka ndodh kjo por ky vit ka qenë problematik përshaka të rritjes enorme të çmimeve dhe tani kemi filluar punët dhe për ndriçimin me shtylla të veçanta bëhet në ato rrugë që shtyllat e elektrifikimit nuk janë pra janë nën tokë ndërsa aty ku ka shtylla të rrjetit elektrik gjithkund në botë bëhet nëpër shtyllat e rrjetit elektrik sepse ajo është kosto e pa përballueshme , kemi pasur probleme me projekte por kemi disa projekte siç është në Përfundim Rruga SkenderBeu, keni ndalje në Projektin e madh të Stadijonit, kemi projektin e ri që do të filloj Dalja për Pejë, tenderin e lumit Llukac, Krena e shumë projekte të tjera, siç e dini buxheti i këtij vitit është miratua në dhjetor dhe aprovimi i ati buxheti ka ardhur në Prill që d.m.th. jemi 4 muaj me vonësë, Ngrohtorja e qytetit se kërkesa për subvencionim të biomasës në bazë të marrëveshjes ka shkua në Qeverinë e Kosovës në Muajin Mars për me e kryer pjesën e subvencionimit dhe përgjigjja ka ardhur në javën e parë të Shtatorit edhe pse kanë shkua me dhjetar komunikime zyrtare për këtë çështje, Tarifat e Ngrohtores caktohen nga ZRRE-ja edhe aty ka pasur kërkesa për e me e rishku çmimin sepse Çmimi i tanishëm dhe i vitit të kaluar nuk i mbulon as shpenzimet e veta e jo për me nxjerr profit, për me punua kaldaja e energjisë duhet një vendim i ZRRE-së që ende nuk e kemi edhe pse kërkesa është shumë moti edhe për këtë çështje kemi biseduar me Qeverinë, Grumbullimi i Biomasës dhe pika grumbulluese duhet kohë dhe jemi duke punuar. Rregullorja e kuvendit është hartuar dhe miratuar nga ju anëtarët e Kuvendit dhe duhet të respektohet.

Kryesuesja: Kërkoj që të respektohet rregullorja e punës së kuvendit mos folni prej vendit dhe respektojeni folësin që është në foltore, të gjithëve ju kemi pajisur me rregullore andaj mos tentoi me e shkel këtë rregullore.

z. Besim Ndau: Pyetja ime ka të bëjë me drejtorinë e shërbimeve publike për nriçimin publik në fshatin Moglic që sa herë kemi kërkuar e kemi marrë aprovimin por ende nuk ka ndodhur realizimi i ndriçimit publik, e njëjta situatë është edhe në fshatin Jahoc edhe pse keni intervenuar aty janë rregulluar vetëm dy drita, gjithashtu edhe për fshatin Bitesh ju keni kthye përgjigjeje se fshati Bitesh është në komunën e Deçanit, andaj kërkojmë që ti kthehet përgjigja si duhet dhe të realizohet ndriçimi Publik në këtë fshat.

znj. Diana Qarkagjia: Në rrugën Yll Morina nga tregu e deri të farmacitë është bërë i pa mundur lëvizja në ditët kur ka treg, si dhe ushqimet hedhen në rrugë dhe rreziku nga qenët endacak është shumë i madh .

z. Ngadhnjim Dana: Për ngrohtoren u tha se nuk ka subvencion unë deshta me pyet se sa janë subvencionet për ngrohtore, si dhe a është e vërtetë se janë dhënë 300,000 euro për dy vite dhe ju i keni shpenzuar menjëherë ato, a janë ndarë subvencione për këtë vit në vlerë prej 70,000euro ndërsa komuna si aksionar 100% i ngrohtores nuk ka nda as një cent për ngrohtoren dhe nuk ka as një plan për ngrohtoren .

Kryetari: Rruga në Bitesh do të kryhet shumë shpejti por problemi ka qenë për shkak të gypit të ujit që nuk kemi pasur mundësi me e ndërruar pa bashkëpunim in e KRU Radoniqit andaj do të kryhet shumë shpejti . Për tregun në Orize shumë shpejt do ti gjejmë zgjidhje kësaj pune, Nga viti 2002 ngrohtorja ka marr subvencion nga Qeveria dhe normalisht që komuna nuk ndan Buxhet për këtë lloj të subvencioneve andaj mos provoni me bërë mbrojtje pa as një bazë. Subvencioni është ndarë në javën e parë të shtatorit kërkesa për subvencionim ka shkua në Mars nga ne, çmimet janë rrit nga muaj Mars deri më tani, Kanali në Rogovë problemi është zgjedhë dhe në këto dy dit ka me fillua operatori me punë sepse është zgjedh ky problem .

z. Haxhi Sejdiu: Informatën për vërshimet do ta diskutojmë në të ndryshme .

znj. Adelina Shehu Kola: Sa i përket atyre dy personave që jetojnë në veturë asnjëherë nuk kemi pranuar kërkesë për strehim dhe nga ajo që ne ju kemi ofruar ata nuk kanë pranuar me ju mbulua shpenzimet e qeras por kanë kërkuar me ju dhënë paratë në dorë e që ne nuk kemi asi mundësie

z. Shkumbim Kastrati: Të gjitha përgjigjeje i tha kryetari, ne jemi duke punuar në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik kemi pasur probleme me kontrata mirëpo tani janë zgjidhë ato probleme dhe do ti mbulojmë të gjitha vendet ku ka nevojë për intervenim . Për sa i përket investimeve publike kapital e kemi prolongime sepse kemi pasur inflacion dhe këtë e dini të gjithë.

Kryesuesja : Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur këtë pikë të renit të ditës

3. Pika e tretë e rendit të ditës : Shqyrtimi dhe miratimi i normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023.

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi dhe miratimi i normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023, prezent e kemi drejtorin e drejtorisë për Buxhet dhe Financa z. Durim Halilaj, të cilin e ftojmë që ta merr fjalën .

z. Durim Halilaj: Norma tatimore në këtë propozim nuk ndryshon sikur që ka qenë në vitet tjera, vlerësimin e pronave e bën Ministria e financave ndërsa ne e caktojmë vetëm normën tatimore e që është në kufijtë minimal sikur që ka qenë edhe në vitin e kaluar .

Kryesuesja : E Hapi Diskutimin për këtë pikë .

Kryesuesja: E qes në votim miratimi i normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023, Kush është: **Për, Kundër, Abstenim.**

Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua **Kështu : 22 për , 0 kundër dhe 2 abstenim ,** pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023

Neni 1

Norma Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 deri 1.9, Kuvendi i Komunës së Gjakovës cakton normat tatimore për vitin 2023 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike si vijon:

- Për njësité bujqësore të parcelave ----- (0.15%)
- Për njësité bujqësore të objekteve ----- (0.15%)
- Për njësité pyjore të parcelave ----- (0.15%)
- Për njësité rezidenciale të parcelave ----- (0.15%)
- Për njësité rezidenciale të objekteve ----- (0.15%)
- Për njësité komerciale të parcelave ----- (0.15%)
- Për njësité komerciale të objekteve ----- (0.20%)
- Për njësité industriale të parcelave ----- (0.15%)
- Për njësité industriale të objekteve ----- (0.17%)

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3 **Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

4. Pika e katërt e rendit të ditës : Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Gjakovës për vitin 2023 .

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Gjakovës për vitin 2023, ashtu siç keni qenë të informuar gjatë gjithë procesit Komuna e Gjakovës i ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara ligjore dhe i ka mbajtur gjithseji 12 dëgjime Buxhetore në rajone të ndryshme dhe i ka marrë kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve ku edhe janë inkorporuar në Projekt Buxhetin e Komunës së Gjakovës për vitin 2023, i falënderoj drejtorët që kanë marr pjesë në këto dëgjime Buxhetore dhe anëtarët e kuvendit gjithashtu sot prezentë e kemi Drejtorin e Drejtorisë së Financave z. Durim Halilaj, e ftoj që ta merr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

z. Durim Halilaj: Komuna e Gjakovës i ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore për hartimin e këtij draft buxheti ku janë organizuar dhe mbajtur 12 dëgjime Buxhetore, në fillim e kemi pranuar qarkoren Buxhetore ku edhe e kemi miratuar Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe pastaj e kemi filluar procesin e dëgjimeve buxhetor pastaj e kemi lëshuar një qarkore të brendshme dhe kemi ardhur deri tek qarkorja e dytë buxhetore që është barazuar me kafit buxhetore që kemi kërkuar në KAB edhe pse kemi kërkuar që të kemi mjete buxhetore më shumë në kategorinë e subvencioneve por nuk kanë lejuar kufijtë buxhetor, të gjitha procedurat që i kanë kërkuar dispozitat ligjore janë marrë për hartimin e këtij draft buxheti deri këtu . Buxheti i propozuar për vitin 2023 është 31,558,423.00 euro , kemi rritje në krahasim me vitin e kaluar në vlerë prej +3,741,492.00 .

Burimet e financimit Grandi i përgjithshëm 13,219,265.00 , Grandi specifik për arsim 10,391,073.00, Granti specifik i Shëndetësisë 3,467,988.00, Financimi për shërbimet rezidenciale 160,000.00, Të hyrat vetanake komunale 4,203,787.00, Financimi për teatro 116,310.00 dhe në total propozim buxheti është 31,558,423.00 .

Kufijtë e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të vlerësuara për Financim për Komunën e Gjakovës për vitin 2023 janë : Paga dhe mëditje 15,120,092.00 , Mallra dhe shërbime 3,750,000.00 Shpenzime komunale 628,700.00 Subvencione dhe transfere 620,500.00 Shpenzime kapitale 11,439,130.00 në total 31,558,422.00 .

Struktura e Buxhetit 2023 : Paga dhe mëditje 15,120,092.00 apo 47.91% Mallra dhe shërbime 3.750,000,00 apo 11.88%, Shpenzime Komunale 628.700.00 apo 1.99%, Subvencione 620,500.00 apo 1.97% Investime kapitale 11,439,130,00 PO 36,25% Në total 31,558,422. 00 . i kemi prezantuar edhe rojekSIONET për dy vitet pasuese .

Struktura e shpenzimeve për buxhetin e vitit 2023 ju kemi prezantuar në tabela që janë pjesë me materialeve të këtij buxheti , shpenzimet e pagave janë të buxhetuara me koeficientet aktual sepse nuk e kemi marrë ndonjë urdhëresë që të buxhetojmë ndryshe nga Ministra e Financave edhe pse është në shqyrtim ligji i ri i pagave . Komuna e Gjakovës e ka buxhetin më të lartë që ka pasur ndonjëherë ky buxhet është real jo ambicioz dhe gjithashtu i falënderoj qytetar se në këtë javë do të tejkalohen edhe të hyrat vetanake pra do të kemi buxhet sublementar ,.

Kryesuesja: Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

z. Ali Tafarshiku: Kërkojmë nga kryetari që mos të merret me tema që nuk i takojnë por të merret me këtë buxhet krijimin e laboratorëve që i ka premtua në zgjedhjet e fundit, ndërtimin e pikave grumbulluese, rritja

e subvencioneve për biznese, subvencionimi i organizatave rinore, fusha e atletikes, pishina olimprike, pika turistike në maje të kunorës të gjitha këto janë punët e juaja që i ke premtua, e tani po e mban Gjakovën peng të zhvillimit për arsye të opozitarizmit të subjektit tendë politik kjo nuk është në rregull. Edhe në KPF kamë bërë pyetje për çerdhe të reja dhe Drejtori i financave na i ka dhënë përgjigje dhe nuk e ka lejua drejtoreshën arsimin. Tek vizioni i qeverisjes shikona tek lista e projekteve kapitale se sa herë e keni të cekur fjalën asfalt dhe e shikoni se cili është vizioni i qeverisjes së juaj, i keni planifikuar rrugët pa planifikim të ujërave të zeza, e kjo po ndodhë pikërisht tek pika e zezë që e keni premtuar në fushat. Riparimi dhe mirëmbajtja e QKMF-së po me intereson sa a është bërë pranimi teknik, tek qendra ditore rekreative për pensionistë janë planifikuar 200,000euro për vitin 2024, dhe nëse ajo pjesë e tokës do të ipet në shfrytëzim pse është ndarë ky buxhet, trajtimi i rasteve sociale dhe i të pa strehve është problem me dekada , mirëpo tek subvencionimi për qira kemi kërkuar që komuna ta ketë një buxhet emergjent për rastet sociale

Kryetari: Para disa jave e kemi marrë nga Qeveria një Urdhërësë që Komunitat nuk kanë me investua në kanalizime dhe ujësjellës sepse janë përgjegjës Ndërmarrjet ujore, deri më tani i kemi ndarë mjetet sa kemi pas mundësi tani po na thuhet mos me investua kemi negociua për me e majit kodin për shkak se kemi nevoja emergjente. Kur flasim për projekte është mirë me u informua më shumë për me e dit se çka po flasim, në rezinë faza e parë është hapja e rrugëve dhe mbulimi me zhavorr, infrastruktura vjen më vonë sepse njëherë është hapja e rrugëve për hapjen e frontit të punës. Për premtimet e mijë kërkoj mos ti përzini me ato të juaja sepse unë disa nuk i kamë thënë nga atë që i thatë ju, Askush në Kosovë nuk ka pri me rritjen e investime të hyra dhe investimeve sa komuna e Gjakovës dhe askush nuk i ka mbajtur më shumë premtimet të gjitha janë tejkalua. Qerdhet qendra ditore për pensionist, e as Sdadioni i qytetit nuk ndërtohen me asfalt dhe ka shumë projekte të mëdha që nuk bëhen me asfalt, dhe nuk jemi duke ndërtua asfalt në hënë apo diku tjetër por në Komunën e Gjakovës dhe aty ku ka banor dhe në dëxhimet buxhetor kanë kërkuar asfaltimin e rrugëve të tyre. Për atë që u tha për abetare e kamë konfirmua pjesëmarrje por nuk kamë qenë i gatshëm me shkua në një tubim të abetares e që arsimtarët janë në grevë, jam taku me kryeministrin disa herë pastaj edhe me ministra dhe bashkëpunoj me ta në mënyrë institucionale.

znj. Mimoza Shala: Më vjen keq për gjuhen që po përdorët nga Kryetari por më vjen mirë që e tha se ka takime të shpeshta me kryeministrin e Kosovës që Kosova e ka një kryeministrin e mirë dhe bashkëpunues . Në rregullore e kemi të drejtën e pyetjeve shtesë që po na shkelet nga kryesuesja. U tha nga Kryetari se Buxheti i kaluar që nuk i ka kaluar e ka vonuar qeveria por atë e ka vonuar komuna sepse nuk merreshit me buxhet po u merreshim me ndërrimin e pozitive të personave. U tha se buxheti asfalt asfalt, me siguri e mbani në mend që në mandatin e kaluar keni premtuar se në atë mandat do të përfundojnë rrugët me asfalt dhe në bazë të këtyre dokumenteve edhe në këtë mandat nuk do të përfundojnë asfaltimet sepse në disa projekte janë të planifikuar në vitin 2025, për ujërat e zeza ka shumë probleme dhe nëse ka ardhë një urdhërësë e tillë ka ardhurat tani e ju jeni që 5 vite në qeverisje, nga 48 projekte të shërbimeve publike 37 janë asfalt , e një është rregullimi i lumit krena është beton e që janë ndarë nga 500,000 euro në vit e që jemi i vetmi qytet që ulem në breg të lumit dhe nuk e shohim lumin nga betoni dhe i kemi par edhe gabimet nga reshjet e fundit që uji nuk u derdhke në lum për shkak të betonit, rruga Dërguat Vokshi edhe pse nuk është nën mbrojtje nuk është në rregull me i ndryshua pamjen e lagjeve të vjetra.

Kërkoj sqarime nga drejtoi i zhvillimit ekonomik, lidhur me rrugën për tek Ujëvara e Fierzës sepse tek një urë aty ishte vendos Beton që nuk kishte as një siguri dhe kërkoj një sqarim se ku ndodhet Kështjella e Lekes. Për sa i përket buxhetitmti Gjinnor edhe ky buxhet ja vlen për me u dëshirua sepse asnjë projekt konkret nuk është për Buxhtim Buxhetor .

Kryetari: Urat dhe shtretërit e lumenjve sot në kohet moderne ndërtohen prej betonit dhe hekurit dhe rrugët ndërtohen me asfalt nuk ka materiale të tjera, për sa i përket kanalizimeve investimet në këto katër vite janë më të mëdha sa nga pas lufta, investim prej 2.4 milion janë dhënë nga komuna për kolektor, në fshatin Cernjan janë dhënë 600,000 euro nuk është që nuk kemi investua, por mjetet për mirëmbajtje mirën nga kompanitë e ujërave, e dimë që ka problem në rrugën Yllka Domi dhe në kyçe të rrugës Dërgut Vokshi dhe kjo ndodh sepse janë të përziera kanalizimet dhe duhet të intervenohet në atë zonë, do të rregullojmë defektin në lumin krena që mos të grumbullohet uji, Rrethojat në këtë pjesë të lumit janë më beton sepse

matja e ujiti e prurjeve kur ka qen piku në vitin 1979 kur janë bërë edhe vërshimet dhe ai mur u vendos për me shërbye edhe si barrierë, sepse edhe unë kamë pas ide me e bërë rrethojën me hekur të lakuar e kjo ka qenë arsyeja në bazë të analizës, dhe në pjesë tjera ku nuk e mbërrin ai pik do të shkojmë me hekur. Prioritete munden me qenë të ndryshme por prioritete në këtë buxhet janë nga unë dhe nga dëxhimet buxhetore këto janë rregullat e përcaktuara nga ligji dhe unë nuk bëj pjesë në njerëzit që i lë të tjerët me vendos çka donë e unë me i qit nënshkrimet kjo nuk ndodh, unë jam duke punuar me i bërë rrugët që shfrytëzohen nga njerëzit për çdo dit nga qytetarët, kam tentua me i krye më herët por nuk kamë mbërri dhe shumë shpejt do të shtrohen e do të kryhen, gjithkund dëmtohen rrugët dhe riparohen rrugët, nuk ekziston asnjë rrugë që kubzat janë shtrua mbi asfalt, të gjitha rrugët në qytetin e vjetër janë rishtrua dhe janë vendos mbi tamponin e betonarmesë e që është pa që është fantastik sepse në qytetin e vjetër për çdo vit është intervenuar dhe tani që dy vite ka rahat dhe nuk ka probleme në atë rrugë

z. Teki Shala: Buxheti duhet të hartohet duke u bazuar në Dokumentet strategjike siç është PZHK dhe KAB, kryetar duhet të dilni publikisht dhe të sqaroni se keni marrë urdhëresë që mos të punoni në kanalizime si komunë sepse atëherë nuk e di pse ndërtohet edhe asfalti sepse ka nevojë që të investohet në ndaljen e hovit të ikjes së rinis sonë, kanalizimet fekale nuk janë të gjitha nën menaxhimin e kompanisë së ujërave sepse në rogove nuk ju paguajna kësaj kompanive. Kërkoj që të kemi një kod për pastrimin e lumenjve, kemi pasur disa dëgjime buxhetore dhe në disa prej tyre nuk kemi pasur asnjë dokument, por në krahasim me KAB ka përmirësime edhe pse ka vend për përmirësime, sepse ky buxhet nuk i paraqet prioritete e prezantuar nga Kryetari, Problem tjetër është buxhetimi gjinor sepse nuk ka një dokument që tregon se komuna e Gjakovës është e interesuara për Buxhetin e përgjegjshëm gjinor sidomos tek pozitat udhëheqëse në institucionet e komunës, ose cili projekt do të ndikoj në aspektin gjinor.

Shpërndarje a mjeteve në mallra dhe shërbime mendoj se duhet të ndahen më shumë për kanalizime dhe për mirëmbajtje, kërkoj që në këtë buxhet të përfshihen edhe rruga Vëllezërit Morina e cila ka nevojë dhe është në gjendje të keqe.

Kryetari: Në bazë të organizatave ndërkombëtare komuna e Gjakovës për dy vite me radhë ka qenë e para në Kosovë, nuk ka projekt që është 100% për të njëjtën gjini por ka projekte që kanë efekt më të madh për njërin gjini e në këtë aspekt nga vitit 1981 çerdhja e parë është ndërtuar në vitin 2021 në Komunën e Gjakovës kemi investua në shtëpinë e sigurt në parqe, dhe kurdo që mundeni me e realizua një projekte që kontribuon në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor jemi të gatshëm.

z. Ferdinand Kola: Ujëvara e Fierzës është në Fierëz dhe do të punojmë për realizimin e këtij projekti ndërsa për urën që shkon tek vaska e currilave aty do të bëhet një urë e drurit për këmbësor por janë bërë një pjesë e bazës së këmbëve me beton, Kështjella e Lekes gjendet në Popoc dhe do të punojmë që ky vend i lashtësisë sonë të del në pah, kemi edhe pjesë tjera të trashëgimisë kulturore dhe me projekte tjera të turizmit.

z. Agustin Shala: Bazuar në draft buxhetin e prezantuar dhe nga debatet e kolegëve parafolës shihet qartë se ky buxhet përfaqëson në mënyrë të drejtë të gjitha kërkesat e prezantuar edhe nga ana e qytetarëve edhe nga baza gjinore, konkretisht dua të ndalemi tek investimet kapitale që ka një shumë të caktuar të mjeteve ne e dimë se të gjitha kërkesat nuk mundemi me i realizua por është një buxhet që është i hartuar në bazë të kërkesave të qytetarëve dhe nga qeveria komunale dhe kërkesave që kanë dalë nga dëgjimet buxhetore që kërkesat kryesore kanë qenë për ndërtimin e infrastrukturës, vlera për investimet kapitale është një vlerë reale për realizimin e këtyre projekteve që kryesisht qytetarët kanë kërkuar asfaltim të rrugëve, sanim të rrugëve ndreqim publik, dertimi i parqeve, kanalizime ujësjellës etj, kemi edhe disa projekte të rekreacionit që janë atraktive që janë shumë të qëlluara por kërkoj që të analizohet edhe kostbenifiti i këtyre projekteve, dhe të kemi një mbikëqyrje të këtyre projekteve pasi që të realizohen. Bazuar në të gjitha këto që u ceken më lartë është një projekt buxhet i mirë i planifikuar mirë gjithëpërfshirës dhe zhvillimor.

znj. Krenare Bushaj: Në këtë buxhet ka mangësi të investimeve në trotuare sidomos në afërsi të shkollave në disa fshatra si dhe tek mirëmbajtja dhe rregullimi i shkollave këtu është cekur lista e shkollave edhe

Shkolla Shtjefen Kurti në Novosell të Ulët dhe këtu është Shkolla Engjell Gjoni në Novosell të Ulët dhe Shtjeven Kurti në Novosell .

z. Besim Ndau: Unë mendoj se në disa zona janë shpërndarë pak mjete psh, tek kodi 28 rrugët e fshatrave Pjetërshan, Kusar, Dol, 50,000 në 2023 dhe 100,000 në vitin 2024, pastaj projekt me nr. 38 Nec, Korenci Orize, Meje, Jahoc shumë fshatra me 200,000 për dy vite a mjaftojnë këto mjete që të kryhen këto rrugë në këto fshatra.

znj. Shqipe Fejza: E vetmja grua që ka kërkuar diçka në dëxhimet Buxhetore ka qenë Drejtoresha e Shtëpisë së Sigurt që ka kërkuar hapësira më të mëdha dhe këtu nuk po i shoh se janë ndarë mjetë, si dhe për tregun në orize ke premtuar kur e kemi marr vendimin për dhënien në shfrytëzim dhe tani nuk ka mjetet të ndara .

Kryetari: Për tregun në Orize dy herë e kemi përsëri shpalljen por nuk ka të interesuar dhe vendimi është valid dhe nuk e ka parapara që komuna me investua por ai që e merr në shfrytëzim, dhe faza e par do të merr komuna vet në menaxhim dhe pastaj të merremi me investime. Për shtëpinë e sigurt ne jemi të gatshëm nëse e kërkojnë në procedura të rregullta ligjore, ne e vazhdojmë financimin sipas memorandumit të nënshkruar, për rrugë projektet janë dy vjeçare, janë disa zona që kemi pas kërkesa për rrugë por janë disa që janë private dhe ne duhet fillimisht ti shikojmë pronësinë .

z. Ledian Rexha: Edhe në vitin e kaluar edhe në këtë vit janë ndarë 8000 euro për rivitalizimin e Qendrave rinore dhe ne nuk e kemi asnjë qendër rinore a është gabim teknik apo si është puna edhe për vitin e ardhëshëm janë ndarë vetëm 10,000 euro a ka me ndodh ashtu edhe në këtë vit sepse kjo ndikon në uljen e konsumuesve të narkotikëve dhe për çështjen që u diskutua më herët banorët ka në bërë kërkesë dhe qe një vit e gjysmë nuk ka marrë përgjigjeje .

Kryetari: Sikur vitin e kaluar jemi vonë me objektin e komunës ju kamë thënë se komuna ka shumë hapësira të vetët që kanë me na mbet barrë kur ne të dalim në objektin e ri dhe hapësirat e zbraztë nëse nuk shfrytëzohen shndërrohen në barrë, dhe për kodon qendrat rinore janë mbete për me e ruajti kodin që të kemi mundësi me i nis procedurat, pra do ti kemi mbi 8 objekte pasi që administrata e komunës shkon në objektin e ri .

z. Ardian Nushi: Sa i përket këtij draft Buxheti është gjithëpërfshirës dhe i shpërndarë në të gjitha zonat e komunës së Gjakovës, tek asfaltimi i rrugëve tek fshatrat Vraniq , Bordosan , Doblibare kemi shumë rrugë dhe mendoj se mjetet e ndara për këto projekt nuk mjaftojnë .

z. Ngadhnjim Dana: Ky debat është i pa denjë dhe është reduktuar në masë të madhe kjo po bëhet nga Kryetari i komunës dhe po ju adresohet me fjalën mikrob dhe kush do që fol me mu ka me e pësua keq ky është kërcenim direkt dhe fjalë të tjera mendoj se nuk është në rregull. Për Buxhetin gjatë gjithë kohës u tha se qeveria po na pengon dhe që në filli u tha se rritja më e madhe është ardh nga Grandi qeveritar kjo është demant i vetvetes dhe kryetari i komunës thotë se tregoma një vend që tha se tregoma një vend ku kanë me u ndërtua urat me dru dhe pastaj drejtori i Zhvillimit Ekonomik e demantoi për urën në Firëz, kërkoj që të kemi specifikim të kodeve, dhe tek disa investime të vogla mendoj se munden mos të specifikohen por kur ka shumë të mëdha nuk munden me i lenë në kode të përgjithësuar, ndërsa për tek kadastra shënon qendra ditore rekreative për pensionistët dhe tek shërbimet rezidenciale është financimi për shtëpitë për personat e moshuar a ka mundësi me ne sqarua se a hyjnë këto mjete tek shërbimet apo tek kapitalet .

Kryetari: Unë i përsërita fjalët e diskutimit tjetër e sa për pjesën e mikrobit unë nuk ju thash as ju as askujt po ta përsëris edhe një herë, se kush do që guxon me më tregu se çka me fol unë e konsideroj mikrob dhe nuk ja lejoj askujt tjetër këtë e thash dhe ta përsërita, Buxheti është i përcaktuar me ligj se sa ju shkon të gjitha komunave dhe ajo rritje u bë me formulën që ekziston dhe nuk është bërë me vullnet të qeveris por përshaka se është rrit buxheti i Shtetit, ndërsa të hyrat e komunës janë rrit pa i ndryshuar as një nome

tatimore pro kjo rritje është bërë me punën dhe me besimin e qytetarëve. Urat nëpër botë ndërtohen me materiale të ndryshme por urat ku kalohet me automjete nuk ndërtohen më askund në botë me dru. Ura për tek vasakt e currilave këmbët e betonit ju mbështillen me gurë dhe mbi bëhet me dru .

z. Agustin Shala: Kërkesat për zhvillim të projekteve ka pasur prej se ekziston njerizimi dhe do të ketë në vazhdimësi kjo është e natyrshme por ne duhet që bashkërisht të punojmë që të realizojmë sa më shumë projekte që janë në interes të qytetarëve .

znj. Shqipe Fejza: Unë kamë një kërkesë që projektet që po realizohen të kenë pjerrina për personat me nevoja të veçanta si dhe pllakëzat për personat e verbër sepse është nevojë e domosdoshme .

z. Durim Halilaj: Buxheti i përgjegjshëm gjinor në komunën e Gjakovës janë të përcaktuar kategoritë që e ndajnë buxhetimin gjinor por të gjitha projektet e investimeve kapitale janë në harmoni me buxhetimin gjinor dhe ashtu janë të realizuara sepse e kemi obligim një gjë të tillë, për sa i përket asaj se po flas në emër të drejtorive, për projektet kapitale unë jam përgjegjës dhe sa i përket asaj që u tha asfalt në përqindje i bije 28% e buxhetit shkon për projekte me asfalt dhe të gjitha këto projekt janë nga dëgjimet buxhetore, shtëpia e sigurt financohet nga kategoria e subvencioneve , Komunitat mundet me financua në kanalizime në bazë të marrëveshjeve ashtu siç e kemi tani me KWF. Ky buxhet është gjithëpërfshirës dhe ju ftoj që ta votoni .

Kryesuesja: E qes në votim miratimin e Buxhetit të Komunës së Gjakovës për vitin 2023 , **Kush është: Për, Kundër, Abstenim.**

Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **u votua kështu: 23 pro, 8 kundër dhe 0 Abstenim** , pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M

Për Miratimin e Buxhetit të Komunës së Gjakovës për vitin 2023

1. Aprovohet Buxheti i Komunës së Gjakovës për vitin 2023

2. Struktura e Buxhetit Komunal për vitin 2023 është si vijon:

- Paga dhe Mëditje	15.120,092,00€
- Mallra dhe Shërbime	3,750,000.00 €
- Shpenzime Komunale	628,700.00 €
- Subvencione dhe Transfere	620,500.00 €
- Investime Kapitale	11,439,130.00 €
Totali	31,558,422.00 €

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Kryesuesja : Faleminderit prej të gjithë juve që e keni votuar dhe kontribuar për këtë draft Buxhet dhe shihem një ore pauz .

5. Pika e pestë e rendit të ditës: Propozim Vendimi për caktimin e një pjese të parcelës nr.P70705077-00107-0 në Z.K Firzë për ndërtimin e “Qendrës Ditore për Pensionistë “ .

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Propozim Vendimi për caktimin e një pjese të parcelës nr.P70705077-00107-0 në Z.K Firzë për ndërtimin e “Qendrës Ditore për Pensionistë, andaj e ftojme kryetarin e Komunës që ta merr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës .

Kryetari: Kjo pikë ka qenë edhe më herët kjo është kthyer nga Ministria një herë dhe pastaj të gjitha drejtoritë i kanë kryer obligimet dhe veprimet e tyre të nevojshme tani nevojitet që kuvendi të merr vendim për caktimin e kësaj parcele për realizimin e këtij projekti i cili ka me qenë shumë atraktiv dhe i mirëseardhur për të gjithë pensionistët që të kenë një qendër ku do ta kalojnë një pjesë të ditës që ata dëshirojnë

Kryesuesja: E Hapi diskutimin për këtë pikë .

z. Ali Tafarshiku: E kamë të pa qartë pikën 4 të këtij propozim vendimi ku thuhet se organet e administratës të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim si do të veprohet a do të menaxhohet në kuadër të drejtorisë për Shëndetësi dhe mirëqenieje Sociale apo do të ipet në shfrytëzim për këtë po kërkoj sqarime .

Kryetari : Prona si e tillë nuk ipet në shfrytëzim por pas ndërtimit do ta japim në shfrytëzim me kushtet që i caktojmë sepse nuk mundemi me e menaxhua sepse aty kërkohet që të ketë personel dhe ne atë nuk e kemi

Kryesuesja: E qes në votim miratimin e Vendimit për caktimin e një pjese të parcelës nr.P70705077-00107-0 në Z.K Firzë për ndërtimin e “Qendrës Ditore për Pensionistë, Kush është: **Për, Kundër, Abstenim.**

Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro kësaj pike** , pas votimit të bërë u miratua Ky :

V e n d i m

1. Caktohet lokacioni për ndërtimin e “Qendrës Ditore për Pensionist” në Komunën e Gjakovës në pjesën e parcelës nr. P.707050077-00107-0 në Zonën Kadastrale Firzë, e evidentuar në pronësi të Republikës së Kosovës .
2. Qëllimi i ndarjes së parcelës është Ndërtimi i “ Qendrës Ditore për Pensionist “për ofrimin e shërbimeve të argëtimit dhe të rekreacionit për Pensionistë, ndërsa investimi do të bëhet nga Komuna e Gjakovës sipas projektit ideor .
3. Caktimi i Lokacionit sipas pikës një (1) të këtij vendimi bazohet në Planin Zhvillimor Komunal 2022-2030 të Komunës së Gjakovës .
4. Obligohen organet e administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave konform nenit 27 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Pa Luajtshme Komunale, dhe nenit 34 dhe 35 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Pa Luajtshme Komunale
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për miratimin e kërkesë për Hartimin e Draft Statutit të Komunës së Gjakovës dhe ndjekjen e procedurave për ndryshimin e Simboleve të Komunës së Gjakovës .

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Propozim Vendimit për miratimin e kërkesë për Hartimin e Draft Statutit të Komunës së Gjakovës dhe ndjekjen e procedurave për ndryshimin e Simboleve të Komunës së Gjakovës andaj edhe për këtë pikë e ftojme Kryetarin e Komunës që ta merr fjalën .

Kryetari: Në Komunën e Gjakovës ka funksionuar një Grup punues për haramin e draft Statutin mirëpo tani e kemi propozua këtu në Kuvend sepse ka pasur ide për ndryshimin e Simboleve të Komunës së Gjakovës dhe nevojitet që të kemi një grup Punues për ndjekjen e procedurave dhe i kamë porpozuar emrat që ju kemi dërguar në propozim vendim është gjithëpërfshirës dhe kërkoj që ta miratoni në mënyrë që zyrtarisht ti ndjekim procedurat ligjore për Statutin dhe simbolet e Komunës .

Janë disa ndryshime që janë obligative me ndodhë për shkak të ndryshimit të ligjeve dhe dy janë substanciale që do të propozohen siç janë zyra për menaxhimin e projekteve dhe ndarja e drejtorisë për Shërbime Publike këto janë substanciale të tjerat janë teknike dhe pastrim i atyre gjërave që janë të tejkaluar

Kryesuesja: E Hapi Diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

Kryesuesja : E qes në Votim miratimin e Vendimit për miratimin e kërkesë për Hartimin e Draft Statutit të Komunës së Gjakovës dhe ndjekjen e procedurave për ndryshimin e Simboleve të Komunës së Gjakovës ,
Kush është : Për , Kundër , Abstenim.

Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro kësaj pike** , pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për Emërtimin e Rrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës me këtë përbërje:

1. Znj. Arbëneshë Kuqi, Kryesuese e Kuvendit .
2. Z. Him Zeqa , përfaqësues i Kuvendit
3. Znj. Ermira Mehmeti, Përfaqësuese e Kuvendit
4. Z. Ngadhnjim Dana, Përfaqësues i Kuvendit
5. Z. Labehat Sadrija , Përfaqësues i Kuvendit
6. Z. Nexhdet Morina, përfaqësues i Kuvendit
7. Znj. Krenare Bushaj, përfaqësuese e Kuvendit
8. Znj. Eranda Baçi , përfaqësuese e Ekzekutivit të Komunës
9. Z. Rozafat Hoxha , Përfaqësues i DUMM-së .

2. Ky Komision në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale, duhet të veprojë në harmoni me dispozitat e Ligjit për Sistemin e Adresave dhe të shqyrtoj ankesat dhe kërkesat e drejtuara për emërtimin e rrugëve në Komunën e Gjakovës .

4. Pas përfundimit të punës së këtij komisioni lista me emërtimet e propozuara të paraqiten në Kuvend për shqyrtim dhe miratim .

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

7. Pika e shtatë e rendit të ditës: Draft Kodi i Etikës në Komunën e Gjakovës

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Draft Kodi i Etikës në Komunën e Gjakovës, kjo pikë është diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe pas konsultimeve lidhur me komisionin që ka qenë i paraparë të themelohet për monitorimin e zbatimit të kodit nga zyrtarët politik kemi marrë rekomandime dhe që ky komision është i pa nevojshëm dhe si ti tillë duhet të heket andaj dokumentin që ju kemi dërguar është pa atë komision , andaj për sqarime më të hollësishme e ftoj kryesuesin e Krupit Punues z. Kushtrim Brahimiaj që ta merr fjalën .

z. Kushtrim Brahimaj: Qëllimi i këtij kodi është që ti përcaktoj rregullt e sjelljes së zyrtarëve të komunës sipas rregullave të standarde të vendosura në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të komunës, materialet i keni marre me kohë dhe me lejon të sqaroj atë që e tha kryesuesja në draftin që ju kemi dërguar tek neni 33 nga paragrafi 4 deri tek paragrafi 10 grupi punues ka propozuar që të hekën nga ky dokument sepse kemi vlerësuar se nuk do të ishte normale që të formohet një komision disiplinor për të

emëruarit publik që do të ju nënshtrohen procedurave disiplinore andaj në emër të komisionit propozoj që nga neni 33 nga paragrafi 4 deri tek paragrafi 10 të hiqen dhe të miratohet pa këto paragrafë .

z. Ali Tafarshiku: Me vjen mirë që në kuadër të këtij dokumenti janë specifikuar edhe disa nga parimet etike që fatkeqësisht deri më sot janë shkel nga niveli më i ulët deri tek aj më i lartë në procedurat e punësimit në Komunën e Gjakovës në procedurat e prokurimit e shumë aspekte të tjera. Në mbledhjen e KPF-së kam kundërshtuar kryesuesin e grupit punues sepse është udhëheqës i zyrës së personelit në të cilën kalojnë të gjitha konkurset e komunës dhe pa dashtë me hy në raste individuale kemi pasur shkelje të procedurave dhe kanë qenë edhe publike. Gjakova dhe ne banorët njihmi shumë mirë me njëri tjetrin dhe i dimë të gjitha shkeljet dhe manipulimet, unë nuk e kam pranua që i nijeti kod të prezantohet nga udhëhapësi i zyrës së personelit në të cilën zyre janë ankesat më të mëdha për shkelje në Komunën e Gjakovës, propozimi për heqjen e nenit 33 pse Zyrtari politik nuk paskan nevojë me i zbatua rregullat e mirësjelljes ky propozim është i çuditshëm, unë konsideroj se heqja e këtij neni se nuk kemi bere asgjë sepse edhe ne te përzgjedhurit politik duhet me ju nënshtrua rregullave te mirësjelljes.

Kryetari: Zyra e prokurimit ne komunën e Gjakove është renguar e para si me transparente në Kosovë Komuna e Gjakovës është rendit e para si Institucioni me transparent ne Kosovë që i ka publiku të gjitha kontratat e prokurimit, Komuna e Gjakovës është Vlerësua me 98 pik për transparencë nga të gjitha organizatat relevante dhe tani dikush thotë se kemi problem me Zyrën e Prokurimit kjo nuk është e saktë dhe po ju them se Procesi i Prokurimit në Komunën e Gjakovës është ndër më të mirat në Ballkan e jo vetëm në Kosovë edhe për Zyrën e Prokurimit i kemi raportet edhe te auditorit edhe të organeve tjera, unë kam biseduar me disa nga anëtarët e komisionit dhe kam kërkuar që disa nga pikat te ndryshohen siç është Tatuja qe ne draft ka qenë nuk lejohen tatutë e që nuk kemi bazë ligjore qe e ndalon, tek Zyrtaret politik unë kam kërkuar qe ti hiqen ato pika sepse do te na shkaktojnë telashe duke krijuar komision disiplinore dhe me i shqiptua masa disiplinore ne njëri tjetrit dhe do te kemi një problem jo te mirë dhe aspak te këndshme prandaj kemi kërkuar mos te kemi kësi probleme pa asnjë nevojë

z. Kushtrim Brahimaj: Ajo që e kemi vërejt lidhur me këto dispozita ka qenë se në secilin vendim të komisioneve disiplinore duhet të ketë edhe një instancë të ankesës dhe për këtë komisionin nuk kemi pasur një mundësi te tillë. Punën tonë e vlerësojnë instancat dhe institucionet Kushtetuese qe e vlerësojnë ligjshmërinë e vendimeve dhe veprimeve qe ne i marrim siç është këshilli i pavarur mbikëqyrës për shërbimin Civil dhe qe 5 vite qe unë jam udhëheqës i asaj Zyre asnjë vendim nuk është anuluar ndërsa në te kaluarën nga 20 vendime janë anuluar 10 vendime, pra ato që u tha këtu nuk qëndrojnë dhe janë tendencioze dhe të pa vërteta .

z. Ali Tafarshiku Ne nuk pajtohemi me propozimin qe te largohen këto pika nga neni 33 i këtij dokumenti dhe kjo qe po tentohet të bëhet është e pa kuptimet dhe e pa pranueshme .

Kryetari: Unë edhe një herë por ju sqaroj se propozimi ka ardhë në mënyrë që të parandalohen veprimet që do të na shkaktojnë dëme të gjithëve që do të na qesin në situata kur ne do ta kemi mundësi me e sanksionua njeri tjetrin pa asnjë bazë ligjore andaj edhe një herë po kërkoj mirëkuptimin e juaj dhe këto pika te largohen nga ky dokument.

znj. Mimoza Shala: Unë mendoj se këto pika nuk duhet te largohen të gjitha duhet te jen përgjegjës për punën e tyre dhe te zbatoj rregullat e mirësjelljes dhe te zbatojnë kotin dhe dokumentet tjera qe e përcaktojnë mirësjelljen e zyrtareve Publik qofshin ata Shërbyes civil apo te zgjedhur Politik .

Kryesuesja: E qes në Votim miratimin e Draft Kodi i Etikës në Komunën e Gjakovës me propozimin që nenin 33 nga paragrafi 4 deri tek paragrafi 10 të hiqen dhe të miratohet pa këto paragrafë, **Kush është: Për, Kundër, Abstenim.**

Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua kështu: 23 pro, 0 kundër dhe 0 Abstenim , pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M
Për
Kodin e Etikës në Komunën e Gjakovës

1. Miratohet Kodi i Etikës në Komunën e Gjakovës .
2. Dispozitat e Kodit të Etikës do të Zbatohen për të gjithë Zyrtarët e Komunës së Gjakovës
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti i Kodit të Etikës në Komunën e Gjakovës .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

8.Pika e tetë e rendit të ditës: Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa Komunale 01 nr.011/01-19340 i dt. 28.07.2022

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa Komunale 01 nr.011/01-19340 i dt. 28.07.2022, Ministra e Bujqësi ka kërkuar që të përfshihen edhe disa taksa në drejtorinë e Bujqësisë edhe pse kanë qenë të rregulluara me Udhëzim Administrim ka rekomanduar që të përfshihen edhe në rregulloren e Komunës andaj i kemi përfshi dhe tani është kompletuar , njëjtë ka vepruar edhe ministria e Shëndetësi dhe i kemi përfshirë në këtë rregullore andaj kërkoj që të mbështetet kjo rregullore me këto rekomandime të ministrive përkatëse .

Kryetari: Për këtë pikë e kemi shqyrtimin e rekomandimeve të Mistrisë së Bujqsisë që ka kërkuar që të përfshihen edhe disa taksa në drejtorinë e Bujqësisë edhe pse ato taksa janë te parapara ne Udhëzimin administrativ e njëjta ka ndodh edhe nga Mistria e Shëndetësisë qe ka kërkuar qe taksat që janë të parprar ane Udhëzimin administrativ te pasqyrohen ne ketë rregullore andaj ju kemi prezantuar sot për shqyrtim dhe kërkoj qe ta përkrahni ne mënyra qe ta përmbushim rekomandimin e ministrive .

z. Teki Shala: Kjo është bërë praktik tani që të kemi nga një rishqyrtim te akteve te kuvendit ne çdo mbledhje unë kam qen kundër disa taksave te parapara ne ketë rregullore edhe ne mbledhjen kur është miratua ky dokument andaj kërkoj që te jemi me profesional e mos te kemi këto telashe me zbatimin e ligjshmërisë .

Kryetari: Komuna ka të drejti me i caktua taksat qe janë kompetenca ekskluzive e komunës dhe ministria nuk ka te drejtë me na caktua taksa për ato qe jemi përgjegjës ne si komune mirëpo kjo ka ndodh është ndërhyrje ne kompetencat e Komunës nga niveli qendror .

Kryesuesja : E qes në Votim miratimin e Rregullores për Taksa Komunale, me përfshirjen e taksave sipas rekomandimeve të ministrive përkatëse , **Kush është : Për, Kundër , Abstenim**

Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua kështu: 16 pro, 7 kundër dhe 0 Abstenim , pas votimit të bërë u miratua Ky :

RREGULLORE
PËR TAKSA KOMUNALE

9. Pika e nëntë e rendit të ditës: Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit 01 nr.011/01-5477 i dt.07.03.2022 për mbështetje Financiare të Shoqatës “Handikos Gjakovë” .

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën për Rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit 01 nr.011/01-5477 i dt.07.03.2022 për mbështetje Financiare të Shoqatës “Handikos Gjakovë”, ku Ministria e Financave ka kërkuar që të ndjekën procedurat përmes thirrjes Publike, të parapara në rregulloren e Ministrisë së Financave për procedurat e subvencionimit të OJQ-ve, andaj ju kemi prezantuar sot për shqyrtim dhe miratim sipas rekomandimit të Ministrisë .

Kryesuesja: E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës

znj. Mimoza Shala:Ne jemi pro mbështetjes së HANDIKOS-it por me intereson çështja kohore sepse ministria e ka kthye me 23 mars dhe sa është afati ligjor me ardhë për rishqyrtim sepse qe një kohë e gjatë paska mbet e pa rishqyrtuar .

Kryetari: Po kanë zgjat procedurat e Thirrjes Publike dhe kjo ka qenë arsyeja, sepse ajo ka qen edhe rekomandimi i Ministria tani janë përfundua të gjitha procedurat e k[ruara dhe ju kemi dërgua për shqyrtim dhe miratim .

Kryesuesja: E qes në votim miratimin e vendimit për mbështetje Financiare të Shoqatës “Handikos Gjakovë”, **Kush është: Për, Kundër, Abstenim.**

Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro kësaj pike** , pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M

Për

mbështetje financiare të shoqatës “Handikos Gjakovë”

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës “Handikos Gjakovë” për mbështetje financiare në vlerë prej 20.000€ me qëllim të përkrahjes për realizimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara që ofrohen nga “Handikos Gjakovë” .

2. Mjetet financiare në vlerë prej 20.000€ për Shoqatën “Handikos Gjakovë” ndahen nga Kategoria e Subvencioneve Komunale të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale në këtë kod 21/632/73950/200/00000/0721 - Drejtoria e Shëndetsise.

3. Obligohen organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi .

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

10.Pika e dhjetë e rendit të ditës: Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit 01nr.0112/02-19351 i dt.28.07.2022 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave për emërtimin e rrugëve.

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit 01nr.0112/02-19351 i dt.28.07.2022 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave për emërtimin e rrugëve, ministria ka kërkuar që të rishikohet ky vendim arsyet nuk janë shumë bindëse sepse vendimi është në harmoni të plot me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si ligj Bazik për Komuna mirëpo keq qenë rekomandim i Ministrisë dhe po kërkoj nga të gjithë që ta mbështesim këtë vendim sipas rekomandimeve të Ministrisë .

Kryesuesja: E hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Ngadhnjim Dana: Këtu decidivisht thotë se mungon baza ligjore dhe se është në kundërshtim me Ligjin për sistemimin e adresave, andaj e kemi bere ndonjë ndryshim apo vetëm po e qesim ne miratim pa ndonjë bazë .

z. Ali Tafarshiku: Komunikimet dhe rishqyrtimet këtu dikuan është problemi tek komuna apo tek Ministrit sepse edhe ata janë Zyrtar Ligjor dhe nuk ka te bej me politik këtu kanë qenë të involvuara dy ministri dhe nuk ka mundësi me gabua të dyja andaj a keni pasur komunikim në mes të zyrave ligjore se ku qëndron problemi në mënyrë që ta dimë se si me veprua dhe mos të na rikthehet prap .

Kryetari: Emërtimi dhe Riemërtimi i rrugëve janë ne kompetencë te Kuvendit dhe kur keni fillua këtë komisioni ju kam tregu se do të keni problematike edhe ligjore edhe praktike sepse një nga kriteret për liberalizimin e vizave është edhe sistemimi i adresave ne qe 20 vite ende nuk jemi rahat me këto emra te rrugëve, unë ju propozoj që nëse e keni harmonizua me e kalu edhe një here dhe të komunikoni me Ministrin që të qartësohen këto situata .

Burim Bajrami: Nga aspekti Ligjore Vendimi i Kuvendit është në harmoni të Plotë sepse Neni 12 dhe 40 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale e specifikon saktë se Kuvendi ka të drejtë të formoj Komisioni që i vlerëson se janë të nevojshme dhe baza ligjore e këtij vendimi është pikërisht në këto nene, ndërsa ministra e planifikimit Hapësinor ka thënë se i mungon baza ligjore në Bazë të ligjit për sistemimin e Adresave gjë që është e pa saktë duke e pas parasysh se vendimi nuk është thirr në këtë ligj dhe se ky ligj nuk e ndalon një gjë të tillë ne kemi komunikuar me Ministrin përkatëse dhe ata kanë rekomanduar që ta qesim në rishqyrtim dhe të mbetet në fuqi prap ky vendim.

Emërtimi i rrugëve dhe i hapësirave tjera të Qarkullimit Publik është ne kompetencë ekskluzive te Kuvendit dhe Kuvendi e ka miratuar këtë vendim i cili është ne harmoni të plot dhe ka bazë të plot ligjore Ministria e planifikimit hapësinor vlerësimin e ligjshmërisë e ka bërë gabimesh .

znj. Mimoza Shala: Ne mendojmë se duhet me ju adresuar zyrtarisht ministrisë dhe me e marrë një përgjigjej zyrtare sepse nuk mundem me e ngrit dorën për me e votua të nijetin vendim pa asnjë ndryshim atëherë pse e ka kthye ministra, që propozoj qe këtë pik te heqim nga rendi i ditës për këtë mbledhje.

Kryetari: Kuvendi sot duhet ta shqyrtoj këtë rekomandim te mistrisë dhe te merr vendim sepse konsiderohet se ne nuk e kemi përmbush rekomandimin e ministrisë për rishqyrtim te vendimit .

Kryesuesja: E qes në votim Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit 01nr.0112/02-19351 i dt.28.07.2022 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave për emërtimin e rrugëve që të mbetet i njëjti komisionin sipas këtij vendimi , Kush është: **Për, Kundër, Abstenim**. Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **u votua kështu: 16 Pro , 0 Kundër dhe 10 abstenim** , pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për Emërtimin e Rrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës me këtë përbërje:

1. Znj. Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit .
2. Z. Him Zeqa , përfaqësues i Kuvendit
3. Znj. Ermira Mehmeti, Përfaqësuese e Kuvendit
4. Z. Ngadhnjim Dana, Përfaqësues i Kuvendit
5. Z. Labehat Sadrija , Përfaqësues i Kuvendit
6. Z. Nexhdet Morina, përfaqësues i Kuvendit
7. Znj. Krenare Bushaj, përfaqësuese e Kuvendit
8. Znj. Eranda Baçi , përfaqësuese e Ekzekutivit të Komunës

9. Z. Rozafat Hoxha , Përfaqësues i DUMM-së .

2. Ky Komision në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale, duhet të veprojnë në harmoni me dispozitat e Ligjit për Sistemin e Adresave dhe të shqyrtoj ankesat dhe kërkesat e drejtuara për emërtimin e rrugëve në Komunën e Gjakovës .

4. Pas përfundimit të punës së këtij komisioni lista me emërtimet e propozuara të paraqiten në Kuvend për shqyrtim dhe miratim .

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

11. Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës: Rishqyrtimi i Vendimit 01nr.011/01-19353/2022 i datës 28.07.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë .

Kryesuesja: Për këtë pikë të renit të ditës e kemi Rishqyrtimi i Vendimit 01nr.011/01-19353/2022 i datës 28.07.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, vendimi është kthyer në rishqyrtim nga Ministria e Planifikimit Hapësinor me arsyetimin se nuk është e paraparë në dokumentet e planifikimit hapësinor andaj jemi të detyruar që ta anulojmë këtë vendim dhe ta përmbushim rekomandimin e ministrisë .

Kryetari: Unë ndihemi shumë keq me këtë rast sepse e kemi një shtetet të Huaj serioz që ka mbledh shumë mjete dhe janë involvuar shumë ambasada për me e nderu një objekt fetar një kish për një komunitet të respektuar e që me plan Zhvillimor nuk ndalohet dhe të kthehet dy herë dhe tani nuk kemi rrugë tjetër vete që ta shfuqizojmë këtë vendim unë po ju tregoj sinqerisht se jam shumë i habitur me këto vendime të përsëritura pa asnjë sqarim .

z. Ali Tfarshiku: Për mungesë të koordinimit po përfundojmë me anulim të vendimit për një organizatë që ka kontribuar shumë në ndihmë të Banoreve të komunës së Gjakovës, unë nuk e kam përgjigjeje që e ka kthyer ministria, andaj kërkoj sqarime se a kemi afat kohor që të gjejmë ndonjë zgjedhje qoftë edhe me ndryshimin e dokumenteve të Planifikimit hapësinor.

Kryetari: Unë nuk kamë pa ndonjë komunë në Kosovë që në Planet Zhvillimor i caktojnë se në këtë pjesë ka me u nderu një Kishë, një Gjami apo objekt tjetra fetar, Ne planin Zhvillimor përshihet se ajo zonë si hapësirë për Komunitet edhe kështu janë parapara krejt zonat, dhe PZHK, nuk kemi të drejt me e rishikua, nuk ka qene për mungesë e komunikimi ose koordinimi sepse me të gjitha nivelet kamë komunikua por nuk ka pas vullnet .

z. Agon Dobruna: Unë fillimisht kërkoj që shërbyesit Civil profesionist duhet ti përgatisin lëndët qartë dhe sipas procedurave ligjore që mos të kthehen më .

Për çështjen Kishës mendoj se qëllimisht është caktuar kjo parcele sepse e keni dit që ka me u kthye, andaj shikojeni e rregulloni mirë vendimet e mos të kthehen më nga ministritë..

Kryetari: Me dal këtu dhe me than se ne e kemi zgjedh lokacionin sepse e kemi dit që ka me u kthye kjo është e ultë, sepse ka diçka apo nuk është këtu ne e kemi zgjedh lokacionin që është qendër në shërbim të komunitetit, ky lokacion ka qen me i përshtatshëm i mundeshem dhe tani na thuhet se nashti e keni zgjedh qëllimisht kjo nuk donë koment . Këtë vendim e kanë shikuar me shumë seriozitet shumë akter dhe nuk lejoj me ju qit hi syve siç po tenton ti andaj mos e bëni këtë, sepse ndoshta vetëm se ka qen kish u kthye edhe unë kam drejt me hamendësua apo .

znj. Mimoza Shala: Ne kemi të drejtë me marr fjalën për të gjitha pikat dhe nuk qëndron ajo që u tha nga kryetari se ndoshta u kthye vetëm se ka qenë kish sepse me pa qenë asht ne kishim votuar kundër që në fillim, nëse u kthye se lokacioni është i pa përshtatshëm atëherë pse nuk po e gjeni një lokacion tjetër .

znj. Shqipe Fejza: U është thënë edhe nga Zyrtarja e Urbanizmit znj. Bejtullahu se Komuna nuk ka të drejtë me nxjerr kështu vendimi duke u bazuar në PZHK, dhe hartat Zonale komuna nuk i ka andaj mendoj se duheni me u konsultua me Ministrin dhe me gjet një zgjidhje ligjore dhe mendoj se këtu është problemi

Kryesuesja: E qes në votim Anulimin e Vendimit 01nr.011/01-19353/2022 i datës 28.07.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë, **Kush është: Për, Kundër, Abstenim.** Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **u votua kështu: 20 Pro , 0 Kundër dhe 1 abstenim,** pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M

Për

Anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01nr.011/01-19353/2022 i datës 28.07.2022

1. Anullohet Vendimi 01nr.011/01-19353/2022 i datës 28.07.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kishës Rilindja e Kosovës në Gjakovë .
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

12. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës: Propozim Vendimi i Kryetarit të komunës për dhënien në shfrytëzim të parcelës nr.P.70705028-04346-4 në Zonën Kadastrale Gjakovë –Jashtë Qytet, për ndërtimin e objektit të Zyrës Regjionale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në Gjakovë

Kryesuesja: Për këtë pikë e ftojme Kryetarin e komunës z. Ardian Gjini që ta marr fjalën .

Kryetari: Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës ka kërkuar që ti sigurohet një parcelë në komune e Gjakovë për ndërtimin e Zyrës Regjionale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në Gjakovë, kemi pasur probleme me gjetjen e lokacionit dhe përfundimesh kemi ardhë në lokacionin që ju kemi propozuar mjetet janë ndarë në ministria e Bujqësisë kërkoj që ta përkrahni.

z. Teki Shala: Pyetja ime është për Kryetarin se a janë rregulluar mirë Procedurat dhe dokumentet që mos të na kthehet nga Ministria.

z. Gjevalin Nikollbibaj: Ne si Drejtori e gjeodezisë e kemi ndarë parcelën sipas kërkesës dhe janë ndejk të gjitha procedurat ligjore për këtë vendim .

Kryesuesja: E qes në votim Propozim Vendimi i Kryetarit të komunës për dhënien në shfrytëzim të parcelës nr.P.70705028-04346-4 në Zonën Kadastrale Gjakovë –Jashtë Qytet, për ndërtimin e objektit të Zyrës Regjionale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në Gjakovë, **Kush është: Për, Kundër, Abstenim.** Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro kësaj pike ,** pas votimit të bërë u miratua Ky :

V e n d i m

1. Parcela me numër P.70705028-04346-4 në Zonën Kadastrale Gjakovë –Jashtë Qytet, në Pronësi të Komunës së Gjakovës, ipet në shfrytëzim afatgjatë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, për ndërtimin e objektit të Zyrës Regjionale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në Gjakovë.

2. Qëllimi i dhënës në shfrytëzim të Parcelës është ndërtimi i objektit të Zyrës Regjionale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në Gjakovë, sipas kërkesës së Agjencisë .
3. Obligohen organet e Administratës të Komunës së Gjakovës si dhe të Agjencionit të Ushqimit dhe të Veterinarisë (AUV) që ti ndjekin procedurat administrative konform dokumentacionit të planifikimit si dhe konformë dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

13.Pika e trembëdhjeta e rendit të ditës: Informatë mbi përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor në Komunën e Gjakovës 2022-2023.

Kryesuesja: Këtë pikë të rendit të ditës e kemi të paraparë në Planin e Punës së kuvendit dhe e kemi paraparë si pikë në këtë mbledhje andaj prezent e kemi drejtoreshën e drejtorisë për Arsim në Komunën e Gjakovës znj. Eranda Baçi të cilën e ftoj që ta merr fjalën .

znj. Eranda Baçi : Fillimisht po ju njoftoj se ka indikacione që filli do të fillojë të hënën dhe patjetër që duhet të flasim pak lidhur me grevën e cila po zhvillohet në qendër të përgatitur me filluar në të gjitha shkollat por mësimdhënësit ju kanë përgjigjur ftesës së ZBASHKU-ut dhe janë hy në grevë, tani disa shkolla kanë vendos dhe kanë filluar mësimin pra janë 6 shkolla që kanë dalë në punë pa asnjë ndikim me dal ose mos me dal , ne si DKA i kemi respektuar kërkesat e mësimdhënësve dhe nuk kemi ndikuar në atë proces. Të arriturat në arsim rritja e subvencioneve për bursa (nga 66 në 83), Hapja e dy çerdheve të reja (Çabrat dhe fshati Novosellë), Fillimi i punimeve në çerdhen e re në Dardani, Hapja e paraleles së mjekësisë në fshatin Rogovë, Hapja e klasës së baletit në Shkollën e Muzikës Prenk Jakova , Në procedurë projekti “Dollap për secilin nxënës”, Molerimi i shkollave bazuar në kërkesat e tyre , Projekti “Hulumtim i jashtëm nga DKA” për nxënësit e klasave të 10 ta për nivelin e përgatitjes të lëndës së gjuhës shqipe (pas fillimit të procesit arsimor), Plani lokal i veprimit për parandalimin e dhunës në shkolla (pas fillimit të procesit arsimor), Ndalim i telefonave në të gjitha shkollat (pas fillimit të procesit arsimor), Zbatimi i rregullores për kodin e veshjes në shkolla (pas fillimit të procesit arsimor), Furnizimi i kabineteve të lëndëve kimi, biologji dhe fizikë në shkollat: SHFMU ‘Zekeria Rexha’, “Yll Morina” SHMLM “Hysni Zajmi” nga MASHT, Furnizimi me pajisje teknologjike për disa shkolla nga buxheti i DKA dhe shkollave, Përfundimi i sallës së edukatës fizike në SHMLE ”Kadri Kusari”, Rrethimet dhe rregullimet e oborreve të shkollave SHMLE”Kadri Kusari”, ” SHMLM “Hysni Zajmi” dhe të tjera.

Numri i nxënësve të regjistruar në klasat e para për vitin 2021-2022 ka qenë 1284 në shkollat e Komunës së Gjakovës, krahasuar me vitin paraprak kemi një rënie të vogël me nxënës të regjistruar për këtë vit të ri shkollor 2022-2023 me gjithsejtë 1110 nxënës .

Numri i fëmijëve në Çerdhe për vitin 2022-2023 është 520

Numri i nxënësve I-V është 5953

Numri i nxënësve VI-IX është 4821

Numri i nxënësve X-XII është 3294,

Numri i fëmijëve dhe nxënësve për të gjitha nivelet për vitin 2022-2023 është 14588 , krahasuar me vitin paraprak kemi një rënie prej 819 nxënës .

Gjithashtu regjistrimi i nxënësve në klasat e X-ta është realizuar sipas Vendimit nga MASHTI-it përmes shpalljes së Konkursit në dy afate ,qershor-gusht sipas kriterëve .

Regjistrimi i nxënësve në klasat e X-ta për vitin shkollor 2021-2022 ka qenë 1243 nxënës , kurse për këtë vit të ri shkollor 2022-2023 kemi një rënie të numrit të nxënësve të regjistruar me gjithsejtë 867 në të gjitha SHML .

1. Gjumnazi “Hajdar Dushi” Gjakovë - 223 nxënës;
2. Gjumnazi”Asllan Berisha” Rogovë - 20 nxënës;

3. SHMLT "Nexhmedin Nixha" Gjakovë - 166 nxënës;
 4. SHMLE "Kadri Kusari" Gjakovë - 240 nxënës;
 5. SHMLMjeks "Hysni Zajmi" Gjakovë - 191 nxënës;
 6. Shkolla e muzikës "Preng Jakova"-14 nxënës
 7. SHMLM "Hysni Zajmi" paralelja e ndarë – Junik- 8 nxënës dhe paralelja e ndarë në Rogovë -5 nxënës
- Pra në këtë vit shkollor 2022/2023 në SHML janë regjistruar gjithsejtë **867 nxënës**.

Kryesuesja: E hapi diskutimin për këtë pikë

znj. Diana Qarkagjia: Fillimisht e përgëzoj drejtoreshën për informatën dhe për çerdhet në Çabrat dhe Novosell që tani janë gati por pyetja ime është se a kanë filluar aplikimet për këto çerdhe dhe se është e nevojshme që edhe në Fshatin Rogov të kemi një çerdhe, si dhe për hapjen e paraleles se mjekësinë Rogovë ndoshta është menduar për Gjimnaz, si dhe për sigurimin e dollapëve në shkolla sigurisht tani kanë filluar procedurat, brengosese është zvogëlimi i numrit të nxënësve, mbyllja e paraleleve të vetëmbyllur, si dhe një pyetje për klasat para fillorë a keni bërë përpjekje që të diskutoni edhe në shkallë tjera të marrin shembullin e shkollave për fillimin e mësimit, A po zbatohet vendimi që e kemi marrë në vitin 2017 që edukatorët të punojnë në dy ndërrime sepse kemi informatë që një vendim i tillë nuk përfillet në të gjitha shkollat si dhe kërkoj informatë në një tabelë me mi dërgua emiri dhe mbiemrin e edukatoreve sa nxënës ka a punon me një apo me dy grupe sepse kemi informata që punojnë me një grup dhe tani nuk kemi cilësi .

z. Ali Tafarshiku: I Përgëzoj shkollat që kanë filluar procesin e arsimit , në raport me grevën a ju lejohej drejtorëve të shkollave që qëndrimet e tyre politike ti shprehin në platformat online që janë të organizuar me mësime ndërkohë , nëse epo e kam një vërejtje për drejtorin e shkollës Ukshin Miftari në Skivjan z. Shefqet Dinaj i cili tallej me figurën e kryeministrit , a mundeni me marrë masë dhe cilat janë ato masa që mundeni me i ndërmarrë .

Kryetari: Për dollapët e shkollave Tenderi ka përfunduar dhe se shpejti pritet me kaluar në procedura të tjera , Për çerdhen në Rogovë vitin tjetër do të ndërtohet kjo çerdhe , për çështjen e drejtorisë në vitin 2019 unë i kam ftuar drejtorët me e ndërpre grevën dhe nuk ka pas pasoja, në këtë vit i kam thirrë jemi takuar pikërisht në këtë sallë i kam kërkuar me u dakorduar me SBASHK-un Nga paslufta ka pas disa kryeministra dhe me të gjitha janë thubtuar dhe janë dalluar me figurat e tyre kjo nuk mund të ketë pasoja dhe nëse dikush mendon se mundet me pas pasoja që e thubton kryeministrin e ka shumë gabim

znj. Mimoza Shala: Unë e përgëzoj drejtoreshën që ka mbajtur qëndrim ashtu siç ka hije lidhur me zhvillimin e grevës në arsim sepse i ka publiku edhe DKA-ja njoftimet për mbajtjen e arsimit në shkollat që kanë thyer grevën.

znj. Eranda Baçi: Me numër të çerdheve jemi shumë mirë dhe tani janë nënshkruar edhe nderimi i dy çerdheve dhe me buxhetin e komunës do të rinovohen dhe adaptohen edhe dy çerdhe në rektat e keqe , po ashtu është e planifikuar çerdhja në Rogov, na ka ngelur me planifikim të MASHT-it edhe në regjionin Dushkajës .

14. Pika e katërmëdhjetë e rendit të ditës : Te Ndryshime

Kryesuesja: Ashtu siç ju njoftova në fillim të mbledhjes tani jemi duke punuar me rregulloren e re të Kuvendit dhe në pikën të ndryshme e kemi të rregulluar kohën dhe mënyrën e diskutimeve dhe kërkoj që ta respektoni në përpikëri rregullorja në mënyrë që të jemi më konkret dhe më të efikas .

Kryesuesja: E hapi diskutimin për këtë pikë .

z. Ali Tafarshiku: Kam një pyetje për Hartat Zonale deri ku ka arritur procesi i Hartimit të Hartës Zonale .

Kryetari : Jemi duke i ndjekim fazat e parapara ligjore është ne diskutim publik do te dërgohet ne ministri dhe do te prezantojmë ne Kuvend pasi te përfundojnë këtë faza qe besoj se do te vije shumë shpejt .

z. Haxhi Sejdiu: Si pasoj e reshjeve te datës 16 dhe 17 shtator Komuna e Gjakovës është përballur me vështirësi te shumta si pasoj e përmbytjes që kanë ndodhur , me marrjen e thirrjes se par ne mesnatën 16 Shtatorit Drejtoria e emergjencave ka qene ne gjendje gatishmërie ku fillimisht kemi intervenuar ne fshatin Gerqin , dhe pastaj jemi marr me konstatimin e gjendjes faktike ne ter territorin e komes se Gjakovës meqrastë janë konstatuar vërshime po thuajse ne te gjitha rrugët e qytetit ku qarkullimi ka qen i vështirësuar, disa lagje kanë pasur më shumë vështirësi siç ne Brekic ku kemi pasur edhe e evakuime

Kryesuesja : Ne momentin kur i e kemi marr këto vendime kemi kontaktuar me te gjitha mekanizmat dhe nuk qëndron problemi i mosprofesioanlizimit te Zyrtareve ligjor ne Komune e Gjakovës por tek mosëharmonizimi dhe mos koordinimi qe jemi angazhuar dhe do te kemi një takim me zyrtaret e MAPL-se pikërisht për këtë çështje, dhe e dyta besoj qe jeni te informuar për procesin e zgjedhjes se Këshillave Lokale kërkoj nga ju te gjithë qe te involvoheni dhe të ndihmoni në këtë peces është procesi i joni dhe duhet të angazhohemi të gjithë që të kemi një proces te mirë .

z. Teki Shala: Një pyetje për drejtorin e emergjencave , u tha se ka qen funksionale 112 qendra e thirrjeve nuk ka qenë ne funksion e kam thirr disa herë dhe nuk ka funksionuar , andaj unë po ju them se niveli i përgatitjes ka qen shumë i dobët dhe janë vërshuar shumë prona dhe ka pasur shumë rrezikshmëri , pra kërkoj qe përgatitjet te jen me te mira dhe me efikase .

z. Haxhi Sejdiu: Qendra operative Emergjente funksionon nga ora 8 deri në ora 24 dhe aq shumë ka pas thirrje sa që nuk ka pas mundësi me i absorvuar ajo qendër te gjitha thirrjet por ka qen funksionale dhe me te gjitha kapacitete tona kemi qen ne teren pra kemi qen me kapacitete vepruese .

Kryesuesja: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e Shpalli të mbyllur këtë mbledhje dhe mirë u takofshim në mbledhjet e radhës .

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 17: 15.

Procesmbajtës

Burim Bajrami



Arbënesha Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit